



Nr. prot. 01-111/01-0077479/25
Pejë, 26.09.2025

Në mbështetje të nenit 78 paragrafi 2, neneve 80 dhe 81 të Ligjit për Zyrtarët Publik Nr.08/L-197, dhe në baze të nenit 8 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, si dhe Udhëzimit Administrativ Nr.01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Komuna e Pejës, publikon këtë:

KONKURS PËR PRANIM

Aplikimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar

- **Titulli i vendit të punës:** Doktor i Mjekësisë
- **Klasa dhe koeficienti i pagës:** H-10, Koeficienti 8.4
- **Kategoria:** Nëpunës i Shërbimit Publik
- **Numri i kërkuar:** Katër (4) Pozita
- **Orari i punës:** 40 orë në javë
- **Periodha e Kontratës:** Me kohë të pacaktuar
- **Kohëzgjatja e punës provuese:** Gjashtë (6) Muaj
- **Institucioni:** Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare - QKMF
- **Mbikëqyrësi:** Shefi i Poliklinikës
- **Data e Publikimit:** 26.09.2025
- **Afati për Aplikim:** 29.09.2025 - 27.10.2025

Detyrat e punës dhe përgjegjësitë për pozitën Doktor i Mjekësisë:

- Ofron shërbime me standard të lartë bazuar në mjekësinë e bazuar në dëshmi;
- Ofron shërbime gjithëpërfshirëse për individin/pacientin dhe familjen në të gjitha episodet e jetës, nën mbikëqyrjen e Mjekut Familjar;
- Harton planin e trajtimit të sëmundjes dhe trajton pacientin si figurë qendrore nën mbikëqyrjen e mjekut familjar;
- Përcakton diagnozë diferenciale dhe diagnozën e punës në përputhje me simptomatologjinë;
- Përcjellja sistematike e rritjes dhe zhvillimit të fëmijëve dhe adoleshentëve;
- Kujdesi për personat e moshuar dhe në nevojë;
- Ofron kujdes në rastet urgjente dhe i referon rastet me kohë dhe në mënyrë adekuate;
- Interpretin rezultatet e testeve të shpejta laboratorike;
- Komunikon ose konsultohet me Specialistë të Mjekësisë Familjare sipas nevojës;
- Referon pacientin te Specialisti i Mjekësisë Familjare dhe për kujdes spitalor;
- Kujdes i vazhdueshëm për pacientët me sëmundje kronike jo ngjitëse;
- Kontrolli i sëmundjeve ngjitëse (hulumtimet epidemiologjike);
- Promovimi shëndetësorë dhe parandalimi i sëmundjeve si dhe shërbimet në komunitete (grupet vulnerabile, vendet rurale, shkolla, komunitete);
- Zbatimi i programit të vaksinimit, Edukimi shëndetësorë etj
- Inkurajohet nga puna ekipore (mjeku familjar, infermieret familjare, infermieret në komunitet);
- Vlerëson efektivitetin e kujdesit të ofruar nga ekipi i mjekësisë familjare , identifikon problemet dhe kërkon nga anëtarët e ekipit zgjedhjen e tyre;
- Përcaktohet nga mjeku familjar si pjesë e ekipit të mjekësisë familjare në përputhje me nevojat e pacientit, aftësitë dhe kualifikimet, për të përmbushur nevojat e institucionit;
- Merr pjesë në trajnime, vlerësim të kompetencave, orientim dhe edukim;

- Komunikon qartë, saktë dhe krijon klimë të mirë për punë që rritë kënaqshmëritë në punë;
- Vepron në mënyrë profesionale duke respektuar rregulloret për KPSH dhe vepron në përputhje me të gjitha rregulloret, procedurat dhe politikat e MSH në fuqi;
- Përcakton diagnozën përfundimtare dhe përshkruan terapinë;
- I nënshtrohet programit nacional të zhvillimit të vazhdueshëm profesional;
- Përkujdeset për konfidencialitetin e individit;
- Përcjellja e sëmundshmërisë nën mbikëqyrjen e mjekut familjarë;
- Identifikimi i grupeve të veçanta të rrezikut;
- Merr pjesë në grupet e rishqyrtimit kolegjal dhe sjell vendime të përbashkëta për menaxhimin e sëmundjeve;
- Ndiemon mjekun familjar në zhvillimin e auditeve mjekësore në institucionin përkatës;
- Merr pjesë në takime, konferenca dhe tregojnë interesin në zhvillimin e strategjive për përmirësim të intervenimeve klinike dhe nivelit të lartë të kujdesit ndaj pacientit;
- Demonstron shkathtësi optimale klinike profesionale;
- Tregojnë aftësi për zbatim të vazhdueshëm të detyrave të punës sipas PVP;
- Tregojnë përkushtim për ngritjen profesionale dhe përmirësimin e kompetencave;
- Respekton plotësisht konfidencialitetin;
- Shkrimi duhet të jetë i qartë dhe i lexueshëm;
- Respekton dhe i përmbahet protokolleve klinike si dhe procedurave administrative në fuqi;
- Organizon punën në vendin e punës;
- Kryen edhe punë tjera të ngjashme në kuadër të Ligjit për Shëndetësi, të caktuara nga ana e eprorit.

Kualifikimi, përvoja dhe aftësitë për pozitën Doktor i mjekësisë:

- Të kenë të kryer Fakultetin e Mjekësisë – Drejtimi i Përgjithshëm;
- Të kenë licencën valide të punës;
- Të njohin punën me kompjuter (e dëshirueshme);
- Njohja e dygjuhësisë (e dëshirueshme).

Kushtet e përgjithshme dhe të veçanta:

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të ketë licencën e punës;
- Njohuri profesionale me përvojën e duhur si dhe aftësi komunikuese e organizative;
- Të zotërojnë njërën nga gjuhët zyrtare në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrat përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për ndonjë vepër penale.

Dokumentet e nevojshme për aplikim:

- Fakultetin e Mjekësisë – Drejtimi i Përgjithshëm;
- Të ketë licencë të punës të lëshuar nga Institucionet përkatëse të Republikës së Kosovës;
- Formulari i aplikimit të plotësuar;
- Rezumeja personale CV;
- Certifikata e lindjes (origjinale)
- Letër njoftimi (kopje)
- Certifikatën mjekësorë që vërteton aftësitë e kandidatit për detyrat e punës
- Certifikatën nga gjykata që nuk është nën hetime ose i dënuar (jo më të vjetër se gjashtë muaj).

Të gjithë kandidatët e interesuar, Aplikacionet mund ti marrin në formë fizike në Arkivën e QKMF-së Pejë, apo t'i shkarkojnë nga web faqja zyrtare e Komunës së Pejës <https://kk.peje.rks-gov.net/peje/> dhe portali shtetërorë <https://konkursi.rks-gov.net>. Dokumentacioni i kompletuar dorëzohet në Arkivën e QKMF-së Pejë.

Vetëm Kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret dhe hyjnë në listën e ngushtë do të ftohen në intervistë.

Të gjithë kandidatët të cilët kanë mbaruar studimet jashtë Republikës së Kosovës e që konkurrojnë për këto pozita, duhet që diplomat e tyre (gradat universitare të fituara) të jenë të njohura (nostrifikuara) nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në pajtim me Udhëzimin Administrativ Nr. 12/2018 të datës 10.09.2018, në të kundërtën Komisioni gjatë selektimit të aplikacioneve do të refuzoj çdo aplikacion të kandidatëve të cilët nuk e kanë plotësuar këtë kusht të konkursit.

Mirëpritën aplikacionet prej meshkujve dhe femrave të të gjitha komuniteteve të Republikës së Kosovës.

Dokumentacioni i cili i bashkëngjitet aplikacionit duhet të jetë fotokopje dhe i njëjti nuk kthehet.

Kandidatët të cilët për zgjidhen, pas shpalljes së njoftimit publik, duhet të sjellin dokumentet origjinale, si dhe certifikatën mbi gjendjen shëndetësore.

Dokumentet e pakompletuara dhe të cilat nuk i përgjigjen kërkesave të konkursit, si dhe dokumentacioni qe mbërrin me vonesë nuk do të merret në shqyrtim.

Për informata më të hollësishme mund të informoheni në Zyrën e personelit të QKMF-së, nr. 49, apo në nr. Tel: 039-423-424, çdo ditë pune deri në orën 14:00.

Rezultatet shpallen në web faqen e Komunës së Pejës: <http://kk.rks-gov.net/peje/> dhe në linkun :<http://konkursi.rks-gov.net/>.